Kronikë

Grabitësit lidhin çiftin e të moshuarve dhe i plaçkisin banesën në Vermosh! Gruaja rrëfen tmerrin: Hynë brenda me automatikë, na morën 30 mijë euro dhe makinën

Një ngjarje e rëndë është shënuar në Vermosh të Malësisë së Madhe. Dy të moshuar janë lidhur e plaçkitur në shtëpinë e tyre gjatë orëve të natës nga persona të panjohur. Pre e grabitjes janë Tom Tinaj me bashkëshorten, në qendër të fshatit Vermosh


Zëvendësuese e dhunuar

Redaksia
2 Qershor, 10:21 | **Përditesimi i fundit: 2 Qershor, 12:23**

SHKODËR- Dy të moshuar nga Vermoshi i Malësisë së Madhe janë grabitur nën kërcënim e armëve. Ngjarje ka ndodhur pas mesnate, kur dy persona me armë dhe të maskuar kanë hyrë në shtëpinë e shtetasit Tom Tinaj, i njohur nga banorët e zonës edhe si Tom Nishi. Pasi e kanë lidhur dhe i kanë grabitur një sasi parash dhe sende të tjera me vlerë, ata janë larguar me duke i grabitur edhe automjetin tip Fuordistradë, të tom Tinajt.

Me plagë në duar e në sy, Mri Tinaj ka treaguar edhe momentet e tmerrit të përjetuara pas mesnatës, pasi dy grabitës ju futën ne banesë dhe u vodhën para e sende me vlerë. Ajo thotë se grabitësit u kanë marrë deri në 30 mijë euro dhe makinën.



LEXO EDHE:
'Në lokal, me armë me vete e municion luftarak', arrestohet 43-vjeçari në Shkodër

'Kanë ardhur dy persona te maskuar dhe me automatikë në duar. Kanë lidhur burrin të parin dhe unë qëndrova me shumë, por me pas më rrahën dhe me lidhen edhe mua. Ne kemi pasur goxha para sepse ka marrë burri kursimet e pensionit, lekët që na kanë gjelltë djemtë plus edhe kemi punuar duke shitur prodhimet tona. Pasi kanë marrë paratë dhe sendet e argjendta janë larguar'- u shpreh ajo.

Në afërsi të fshatit Selcë të Malësisë së Madhe, dy grabitësit kanë humbur kontrollin ndaj mjetit dhe janë përplasur me një kodër. Ata kanë lënë 'Fuoristradën', dhe kanë ecur në këmbë rreth 1 km dhe më pas në fshatin Selcë kanë grabitur një tjetër mjet në pronësi të shtetasit Juli Hysaj.

Më pas dy grabitësit kanë lënë automjetin dhe në të brenda kanë lënë levën me të cilën dyshohet se kanë shpërthyer shtëpinë në Vermosh si dhe armën e zjarrit kallashnikov dhe janë larguar.

Të favorizuar edhe nga errësira dhe një zonë malore e cila është në kufi me Malin e Zi, dyshohet se dy grabitësit janë larguar drejt vendit fqinjë.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 12:03

Me plagë në duar e sy, flet gruaja që u grabit në Vermosh: Hynë brenda me automatikë dhe na lidhën



Me plagë në duar e në sy, Mri Tinaj tregon momentet e tmerrit të përjetuara pas mesnatës, pasi dy grabitës ju futën ne banesë dhe u vodhën para e sende me vlerë. Ajo thekson se autorët kanë hyrë brenda me automatikë, duke lidhur e dhunuar më parë burrin, dhe pastaj edhe atë.

'Më thanë ku i keni paratë. Ne i thamë që nuk kemi, por ata na dhunuan dhe pastaj i treguam. Kanë marrë paratë dhe më pas janë larguar duke na lanë të lidhur. Unë jam dëmtuar më shumë ndaj edhe kam ardhur në spital. Kemi qëndruar për rreth një orë e gjysëm të lidhur dhe unë kam ecur duke u zvarritur deri sa kam shkuar në kuzhinë. Aty kam marrë një thike dhe jam liruar. Kam njoftuar komshinjtë dhe me pas edhe policinë. Policia duke ardhur rrugës ka hasur me automjetin e aksidentuar që na kanë marrë autorët nga oborri i shtëpisë. Ne kemi pasur goxha para sepse ka marrë burri kursimet e pensionit, lekët që na kanë gjelltë djemtë plus edhe kemi punuar duke shitur prodhimet tona. Pasi kanë marrë paratë dhe sendet e argjendta janë larguar", shprehet gruaja e traumatizuar nga ngjarja.

M.Q./Shqiptarja.com

TAG: vermosh | malesi e madhe | Shkoder | tom tinaj


Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Shqipëria ndalon përdorimin e qeseve plastike njëpërdorimshe, a jeni dakord me vendimin?

PO JO NUK E DI

Lajme të tjera

Kronikë

VIDEO/ Shpërthim me tritol në banesën e efektivit në Shkodër, e gjithë familja ishte brenda! Dëshmia në polici: Nuk kam konflikte me askënd
2 Qershor, 07:10

Sport

Shkodra pa gjumë, futbollistët e Vllaznisë pritet si heronj! Presidenti Xhaferri: Jemi të veçantë
1 Qershor, 12:18

Kronikë

Gjendet e vdekur 37-vjeçarja në një livadh në Shkodër! Prej 23 ditësh e larguar nga banesa (VIDEO)
31 Maj, 17:40

Kronikë

Del FOTO/ Humbën jetën pasi ranë në kontakt me energjinë elektrike në dush, kush është mamaja dhe dy vajzat që vdiqën në Fushë-Arrëz
30 Maj, 09:51

Kronikë

Operacioni për drogë në Dukagjin, përveç efektivit që ra në humnerë, i plagosur edhe një koleg i tij! Policia s'e raportoi, Ambasada e SHBA-së e 'nxjerr zbuluar'
29 Maj, 09:44

Kronikë

Bien në kontakt me energjinë elektrike, vdes nëna me dy vajzat në Fushë-Arrëz! Njëra po lahej në dush, e ëma dhe motra i shkuan për ndihmë! Plagoset djali
28 Maj, 17:36

Kronikë

Kontrollet për drogë në Dukagjin, nënkomisari bie në humnerë, nxirret pas 12 orësh! Dështon helikopteri shqiptar, KFOR dërgon policin te Trauma! VIDEO nga momenti shpëtimit
28 Maj, 10:36

Kronikë

Plagosi 11 vjeçarin me armë zjarri, arrestohet i riu në Lezhë
27 Maj, 22:48

Kronikë

Zbulohet një 'fermë' kriptomondhash në Shkodër, sekuestrohen 16 pajisje! Vihet në pranga 43-vjeçari, në kërkim një i ri
27 Maj, 15:30

Kronikë

Prag tragjedie në Pukë, 17-vjeçari plagos me armë një 11 vjeçar, objektiv kishte kushëririn e tij! I mituri me urgjencë drejt Tiranës! Policia në kërkim të autorit
26 Maj, 16:32

Kronikë

Digjet apartamenti në Shkodër! Zjarrfikësit 1 orë beteje me flakët, e moshuara u bllokua në ballkon! Dërgohet në spital në gjendje të rëndë (VIDEO)
25 Maj, 09:02

Kronikë

Tjetërsimi i pronave në Shënjgjin, Gjykata dënon me burg 3 vëllezër, çështja ndaj të cilëve ishte veçuar
Elvis Hila
24 Maj, 17:03

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
Gërthuritni

© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje